

Eshk. Këshillit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr 4646 prot.

Gramsh, më 21 / 11 / 2023

Relacion

Për dhënien në përdorim pa kundërshtim të një pjese të objektit me emërtimin "Y" familjes së shtetasit Gentjana Abazi.

Familja e znj. Gentjana Skënder Abazi jeton në fshatin Snosëm, Njësia Administrative Kukur, në kushte shumë të vështira ekonomike.

Duke qënë se znj. Gentjana Abazi jeton me bashkëshortin dhe djalin me problem shëndetësorë, kanë kërkuar nga bashkia Gramsh t'i ofrojë një ambient për strehim pasi nuk ka mundësi financiare për të siguruar një banesë.

Nisur nga kushtet shumë të vështira të kësaj familjeje ,si dhe të kërkesës me nr.prot 4488 datë 13.11.2023 të znj. Gentjana Abazi drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe këshillit bashkiak për të siguruar një ambient për të jetuar ,ne sot paraqesim këtë relacion dhe p/vendim para Këshillit të Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social",neni 73,njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për zbatimin e politikave të strehimit

Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.

Në përcaktimin e kushteve sipas ligjit kemi :

- a) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
  - i) familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
  - ii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
    - i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

Bashkia Gramsh i ka ofruar znj.Gentjana Skënder Abazi në objektin "Y" me numër pasurie 155/3,Zona Kadastrale 2167 ,në fshatin Kocaj ,një ambient banimi me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> ,të cilën do ja kalojmë në përdorim pa kundërshpërblim.  
Sa më sipër i propozojmë këshillit të bashkisë të miratojë dhënien e ambientit në përdorim të znj.Gentjana Skënder Abazi pa kundërshpërblim.

**Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehimit**

**Ejona BLOSHMI**



**KRYETARI I BASHKISË**

**Besjon AJAZI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 4646/1 prot

Gramsh, më 21/11 /2023

P/Vendim

Nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_ .11.2023

**Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të një pjese të objektit me emërtimin "Y", familjes së shtetasit Gentjana Abazi.**

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit, "Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të një pjese të objektit me emërtimin "Y" ,familjes së shtetasës Gentjana Skënder Abazi , banuese në fshatin Snosëm , Njësia Administrative Kukur", bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", nenet 19, 63, 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015,"Për vetëqeverisjen vendore", neni 8,pika 2; neni 54,gërma "e" :

**V e n d o s i:**

- I. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të ambientit me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> në objektin me emërtimin "Y" me numër pasurie 155/3,Zona Kadastrale 2167 ,në fshatin Kocaj, për banim familjes së znj. Gentjana Skënder Abazi.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I Emergjencave Civile,Stehimit dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Xhulia Gjini

Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Enis ZANI